



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25 regjistër (JR)
Datë 26.06.2020

Nr. 12 i vendimit
Datë 29.04.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Gjyqtare
Mimoza Tasi	Gjyqtare
Sokol Çomo	Gjyqtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 29.04.2022, ditë e premte, në orën 11:55, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Simon Pashuku, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 47, 51/1, geramat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim

dhe parashtrime, i cili ka kërkuar përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Simon Pashuku, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, ushtronte funksionet e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Sipas parashikimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Mbështetur në faktet që kanë rezultuar përgjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Komisionit ka arritur në konkluzionet përfundimtare se subjekti i rivlerësimit:
 - a) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
 - b) nga analiza financiare, nuk ka pasur mjete monetare të mjaftueshme në vlerën (-) 3.238.692 lekë për të paguar këstin e parë të apartamentit në vitin 2006 me sip. 120 m², ndodhur në rr. “{***}”, Shkodër; dhe
 - c) nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të likuiditeteve bankare dhe të parave fizike (gjendje cash) deklaruar në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”).

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 23.09.2019, ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore¹.

¹ Vendimi i arsyetuar i trupit gjykues të Komisionit nr. {***}, datë 22.11.2019, iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 16.01.2020, Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 14.01.2020, dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 14.01.2020, ndërsa vendimi nr. {***}, datë 14.01.2020, i trupit gjykues të Komisionit për korrigjimin e gabimeve materiale në numrin e aktit dhe të vendimit të arsyetuar, iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 16.01.2020 dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 15.01.2020. Ndaj vendimit të arsyetuar dhe të

4.1. Lidhur me shkaqet me natyrë procedurale, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se trupi gjykues:

- a) kishte cenuar garantimin e paanësisë, pasi
- b) nuk i njoftoi menjëherë përbërjen e trupit gjykues;
- c) nuk kishte marrë në shqyrtim provat e kërkuara prej tij;
- ç) procesi i rivlerësimit ishte kryer vetëm mbi një kriter;
- d) vetë i kishte mbledhur dhe vlerësuar provat;
- dh) kishte shtrembëruar faktet; dhe
- e) masa e shkarkimit nuk mund të merrej nëse nuk kishte deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

4.2. Lidhur me apartamentin me sip. 120 m², në rr. “{***}”, Shkodër, me vlerë prej 60.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- a) burimi i kështit të parë prej 30.000 eurosh, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2006, ka qenë vetëm kredia sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2008, nga {***}, nëpërmjet së cilës janë shlyer huatë e marra, fillimisht nga z. E. R.² dhe më pas nga znj. M. D.;
- b) huaja prej 30.000 eurosh nga z. E. R., e marrë në dhjetor të vitit 2006 dhe e shlyer në dhjetor të vitit 2007, si dhe huaja prej 1.400.000 lekësh nga znj. M. D., e marrë në dhjetor të vitit 2007 dhe e shlyer në maj të vitit 2008, janë shlyer pas marrjes së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2008, si dhe nëpërmjet dhurimeve në vitin 2008 të familjarëve, përkatësisht prej:
 - i) 20.000 eurosh, nga vëllai F. P.,
 - ii) 5.000 eurosh, nga motra M. L.;
 - iii) 8.000 eurosh, nga motra N. P.;
 - iv) 5.000 eurosh, nga motra M. B.;
 - v) 3.000 eurosh, nga vjehri J. M..

4.3. Lidhur me ndërtesën me sip. 56 m² dhe pistën me sip. 40 m², në fshatin {***}, Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- a) mosdeklarimi i vlerës së ndërtimit ka qenë pasaktësi, pa pasur për qëllim fshehjen, duke gjykuar se mjaftonte deklarimi sipërfaqes;
- b) ndërtimi ishte bërë prej tij dhe vëllait, z. F. P., por deklarimi për legalizim, datë 06.11.2006, është kryer prej tij për shkak se vëllai ndodhej në Itali;

*korrigjuar, është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.01.2020, i cili u pranua me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili gjithashtu iu njoftua subjektit të rivlerësimit, Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.*

² *Sipas ekstraktit me datë regjistrimi 14.02.2017 të QKB-së, shkresës nr. {***} prot., datë 01.11.2019, të DRTSh-së dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2019, ku huadhënësi, z. R., referohet me emrin “{***}” dhe jo “{***}”.*

c) pronësia mbi truallin e bënte edhe vëllain bashkëpronar.

4.4. Lidhur me depozitën prej 20.000 eurosh në {***}, llogarinë prej 11.054 eurosh në {***}, dhe gjendjen *cash* prej 1.200.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- a) të ardhurat për krijimin e depozitës, llogarisë dhe gjendjes *cash* e kanë burimin nga qiraja e ndërtesës dhe pistës në fshatin {***}, Shkodër, për periudhën mars 2006 - dhjetor 2012, dhënë qiradhënësit N. P., për ushtrim aktiviteti tregtar;
- b) kontrata e qirasë me z. N. P. ka qenë verbale, e përtërirë viti pas viti;
- c) për pagimin e detyrimeve tatimore, ka qenë i detyruar qiramarrësi dhe subjekti nuk ishte në dijeni nëse z. N. P. ishte regjistruar në organet tatimore dhe nëse ai kishte paguar apo jo detyrimet;
- ç) ka shlyer detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja, vërtetuar me shkresën nr. {***} prot., datë 06.11.2019, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër (në vijim “DRTSh”).

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

5.1. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Simon Pashuku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit kërkon që të ndryshohet, ajo bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

6. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15

ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit³, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

7.1. Nëpërmjet ankimit të datës 28.01.2020 dhe parashtrimeve të datës 22.04.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kalimin për gjykim të çështjes në seancë gjyqësore publike, vazhdimin e hetimit për tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, me qëllimin për të administruar dhe marrë në shqyrtim edhe provat për komponentët e figurës dhe të aftësive profesionale dhe, përfundimisht, ndryshimin e vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

7.2. Për të përcaktuar formën e gjyimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi të shqyrtonte në mënyrë të integruar pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet procedurale nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht se: i) është cenuar garantimi i paanësisë pa iu njoftuar menjëherë përbërja e trupit gjykues; ii) trupi gjykues nuk kishte marrë në shqyrtim provat e kërkuara prej tij; iii) procesi i rivlerësimit ishte kryer vetëm mbi një kriter; iv) trupi gjykues vetë i kishte mbledhur dhe vlerësuar provat; v) kishte shtrembëruar faktet; vi) masa e shkarkimit nuk mund të merrej nëse nuk kishte deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Kolegji i mori në shqyrtim pretendimet e subjektit që adresoheshin ndaj procesit të rregullt ligjor, duke arsyetuar si më poshtë vijon.

7.2.1. Mosnjoftimi i menjëhershëm nga Komisioni, pas hedhjes së shortit të datës 15.03.2018, me përbërjen e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen që i përkiste subjektit të rivlerësimit, nuk cenon garantimin e paanësisë sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016.

7.2.1.1. Ky fakt nuk përbën pengesë ligjore për anëtarët e trupit gjykues të Komisionit për të shqyrtuar çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim “K.Pr.Administrative”) apo të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”). Kolegji vëren se, me fillimin e hetimit administrativ nga relatorja e çështjes në datën 15.03.2018, vetë anëtarët e trupit gjykues kanë çmuar se nuk gjendeshin në

³ Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi i arsyetuar në datën 16.01.2020, dhe ankimi i subjektit të rivlerësimit është paraqitur në datën 28.01.2020.

kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, duke nënshkruar edhe deklaratat përkatëse të mosqenies në konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit.

7.2.2. Subjekti i rivlerësimit është njohur me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit në datën 25.10.2019, pas përfundimit të procedurave të hetimit, gjatë kalimit të barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, por pavarësisht kësaj nuk rezulton që ai të ketë ngritur pretendime lidhur me ekzistencën e ndonjë pengese ligjore apo konflikti interesi, që do të mund të përbënte shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit. Kjo do të thotë se nuk rezulton të kenë ekzistuar shkaqe që mund të legjitimonin kërkesën për përjashtimin e ndonjë prej anëtarëve të Komisionit e që nuk lidheshin me procesin e rivlerësimit, por me rrethana objektive e personale të secilit prej tyre në raport me subjektin e rivlerësimit.

7.2.2.1. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, pretendimet mbi anshmërinë e trupit gjykues të Komisionit i ka ngritur vetëm pas kthim-përgjigjes së Komisionit, nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*-in e datës 05.11.2019⁴, dhe pas vendimit të Komisionit të datës 12.11.2019⁵, pra praktikisht vetëm pasi Komisioni kishte marrë vendime lidhur me kërkesat procedurale të subjektit, kundra qasjes apo vullnetit të tij. Këto rrethana faktike, në vlerësimin e Kolegjit, tregojnë se ndonëse ka një vonesë në komunikimin e përbërjes së trupës gjyquese të Komisionit, nuk rezultojnë të dhëna të natyrës objektive dhe subjektive që të vënë në dyshim paanësinë e Komisionit në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi, për pasojë ky pretendim konsiderohet se nuk ka cenuar procesin e rregullt të zhvilluar ndaj subjektit të rivlerësimit dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimmarrjes.

7.2.3. Ndryshe nga sa subjekti i rivlerësimit pretendon, Kolegji vlerëson se Komisioni, në mënyrë të balancuar, ka garantuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, pa ia mohuar këtë të drejtë, por duke i dhënë mundësinë e paraqitjes së provave edhe në seancën dëgjimore të caktuar në datën 15.11.2019.

7.2.3.1. Kolegji, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 3 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se veprimet e mësipërme të Komisionit janë në përputhje me parimin e objektivitetit dhe të shqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

⁴ Se: “[...] Për dokumentacionin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës [...] të cilat janë dërguar në adresë të Komisionit në gjuhën angleze, mund të depozitohen nga ana juaj në formën e kërkuar ligji, deri në datën 15.11.2019, ditë kur planifikohet të mbahet edhe seanca me ju si subjekt rivlerësimi”.

⁵ I cili vendosi: “[...] 2). Të mos pranohet kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Simon Pashuku, për rihapje të hetimit, për arsye se Komisioni e ka bazuar përfundimin e hetimit deri në këtë fazë të hetimit, vetëm në kriterin e pasurisë pasi provat për këtë kriter kanë arritur nivelin e provueshmërisë për subjektin, në përputhje të plotë me nenin 4, pika 2. 3). Të refuzohet kërkesën për “Marrje provash me dëshmitarë” të shtetasve M. D., E. R. dhe J. M., pasi vlerëson se bazuar në nenin 49/6/a të ligjit nr. 84/2016, thirrja e tyre është e panevojshme për sa ato kanë shprehur vullnetin e tyre në formë të shkruar nëpërmjet deklaratave noteriale, paraqitur nga subjekti e të administruara para Komisionit. 4). Të refuzohet kërkesën për “Marrje provash me dëshmitar” të z. P. G., të shtetasve S. T. dhe të shtetasit A. S., pasi bazuar në nenin 49/6/d”, me anë të tyre pretendohet të provohen fakte që edhe po të konsiderohen të vërteta, nuk ndikojnë në marrjen e vendimit [...]”.

7.2.4. Për sa i përket pretendimit se procesi i rivlerësimit është kryer vetëm për një kriter, atë të pasurisë, sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) në çështjen gjyqësore Xh. kundër Shqipërisë⁶, një situatë e tillë procedurale çmohet nga Kolegji se nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjyqësore të Komisionit apo paracaktim të vendimit, për arsye se kryerja e procesit vetëm për një kriter është e bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.2.5. Për sa i përket pretendimit se masa e shkarkimit nuk mund të merrej, për sa kohë nuk gjendej në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, bazuar në jurisprudencën e deritanishme, të konsoliduar⁷, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur, pasi shkeljet e dispozitave që lidhen me deklaramin e pamjaftueshëm të pasurisë sipas ligjit, kanë të njëjtën peshë sikurse shkeljet për kriteret e tjera të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe janë konsideruar të mjaftueshme për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

7.2.6. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se trupi gjyqësor i Komisionit ka cenuar parimin e paanësisë për shkak se vetë i ka mbledhur dhe vlerësuar provat, me anë të këshilltarëve ekonomikë e ligjorë, dhe vetë ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit mbi provat e veta, Kolegji, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme⁸, çmon se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, për sa kohë veprimtaria e trupit gjyqësor të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017.

7.2.6.1. Në çështjen gjyqësore Xh. kundër Shqipërisë, për pretendime të njëjta të kërkuases me sa më sipër⁹, GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”) në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme¹⁰.

7.2.7. Për sa i përket pretendimit se Komisioni ka shtrembëruar faktet duke konstatuar se subjekti nuk kishte deklaruar në ILDKPKI huan prej 1.400.000 lekësh, të marrë në vitin 2007 nga znj. M. D. dhe as shlyerjen e kësaj huaje në vitin 2008, Kolegji vlerëson se qëndron pretendimi i subjektit se Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të gabuar faktet¹¹ si më sipër. Rezulton se në periudhën 2007 - 2008, subjekti i rivlerësimit nuk ishte subjekt deklarimi në ILDKPKI, pasi ushtronte funksionin e oficerit të policisë gjyqësore, për pasojë mosdeklarimi i tij për këtë rrethanë të pretenduar, nuk mund të konsiderohet si një veprim i kryer në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe as mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

⁶ Vendimet nr. 12/2018(JR), nr. 10/2019(JR), nr. 19/2021(JR) dhe nr. 34/2021(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

⁷ Vendimet nr. 12/2018(JR), nr. 10/2019(JR) dhe nr. 19/2021(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

⁸ Vendimet nr. 34/2021(JR) dhe nr. 5/2022(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

⁹ Paragrafi 230 i vendimit të GjEDNj-së Xh. kundër Shqipërisë.

¹⁰ Paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

¹¹ F. 7 e vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

7.2.7.1. Pavarësisht konstatimit të gabuar nga ana e Komisionit, Kolegji vëren se ky konstatim nuk ka sjellë pasoja në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit dhe gjithashtu vlerëson se ky konstatim i gabuar nuk mund të ngrihet në nivelin e cenimit të garantimit të paanësisë, në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016

7.3. Në konkluzion të arsytimit të mësipërm lidhur me shkaqet e ankimit që adresohen ndaj shkeljeve procedurale, Kolegji vlerësoi se nuk rezultojnë rrethana që tregojnë se vendimi nr. 213, datë 22.11.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të jetë bazuar në shkelje të rënda procedurale apo gjendje faktike të konstatuar gabim, si shkaqe që justifikojnë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, sipas parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, çështja u gjykua në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi sipas parashikimit të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

8. Kolegji i ka vlerësuar shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë, nëpërmjet verifikimit të saktësisë së deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe kontrollit për justifikimin me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*. Në funksion të kontrollit gjyqësor të vendimit të Komisionit, Kolegji ka krahasuar të dhënat e deklaratës *vetting* me deklaratimet e interesave të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, sipas individualitetit të çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit¹². Kolegji është bazuar në faktet e provuara gjatë hetimit të çështjes në Komision, duke u dhënë vlerë provuese deklarimeve të interesave të mëparshme tek ILDKPKI-ja, sipas ligjit, dhe, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, vlerë të kufizuar provuese deklaratave të lëshuara në funksion të procesit të rivlerësimit¹³.

B.1. Lidhur me apartamentin në rr. “{*}”, Shkodër**

9. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi apartamentin me sip. 120 m², në rr. “{***}”, Shkodër, me vlerë 60.000 euro. Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2006, kësti i parë i çmimit të dakordësuar për këtë pasuri, i ishte dhënë sipërmarrësit nga subjekti me lidhjen e kontratës, ndërsa kësti i dytë me përfundimin e ndërtimit të apartamentit. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar:
 - a) kredinë prej 25.000 eurosh nga {***}, marrë në prill 2008¹⁴; dhe
 - b) dhurimet nga vëllai dhe motrat në vitin 2008.

¹² Vendimet nr. 20/2021 (JR) dhe nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹³ Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018 (JR), nr. 8/2018 (JR), nr. 9/2018 (JR), nr. 10/2018 (JR), nr. 12/2018 (JR), nr. 9/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR), nr. 12/2021 (JR) dhe nr. 31/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁴ Sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2008.

9.1. Për sa i përket deklaramit të burimit, Kolegji vëren se në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës 2012 (në vijim “deklarata fillestare 2012”), për apartamentin në rr. “{***}”, Shkodër, subjekti ka deklaruar se ka paguar vlerën prej 60.000 eurosh, sipas kontratës së sipërmarrjes në datën 07.12.2006, ndërsa në datën 15.04.2016¹⁵, gjatë shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, ka deklaruar se si burime krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer:

- a) kredia nga {***} në prill 2008, në vlerën prej 25.000 eurosh;
- b) dhurimet në vitin 2008 nga familjarët, përkatësisht nga:
 - i) vëllai, z. F. P., në shumën prej 20.000 eurosh;
 - ii) motra, znj. N. P., në shumën prej 8.000 eurosh;
 - iii) motra, znj. M. B., në shumën prej 5.000 eurosh;
 - iv) motra, znj. M. L., në shumën prej 5.000 eurosh; dhe
 - v) vjehri, z. J. M., në shumën prej 3.000 eurosh.

9.1.1. Sipas deklaramive të dhëna në Komision, në datën 09.04.2019, subjekti, për të paguar këstin e parë të banesës në Shkodër, kishte marrë hua shumën prej 1.400.000 lekësh nga znj. M. D.¹⁶, ndërsa pas rezultateve të hetimit, në datën 07.11.2019, ka shpjeguar se për të paguar këstin e parë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2006, kishte marrë hua nga z. E. R. shumën prej 30.000 eurosh.

9.1.2. Duke krahasuar deklaramit në ILDKPKI me deklaramit e kryera në funksion të procesit të rivlerësimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, huatë nga z. E. R. dhe znj. M. D. nuk i ka deklaruar në deklaratën *vetting*, as në deklaratën fillestare 2012 në ILDKPKI apo gjatë shpjegimeve të dhëna në funksion të hetimit nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, por vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, si pasojë e hetimit të Komisionit dhe pas kalimit të barrës së provës.

9.1.3. Kolegji vëren se deklarimi i marrjes së huas nga z. E. R. në vitin 2006 dhe i marrjes së huas nga znj. M. D. në vitin 2007, janë kryer në mungesë të konsistencës për kronologjinë dhe rendin e veprimeve financiare dhe, siç do të arsyetohet më poshtë, edhe në mungesë të provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e tyre nga këta shtetas.

9.1.4. Subjektet e rivlerësimit mbartin detyrimin që për secilën pasuri, të deklarojnë burimin e krijimit në momentin e krijimit të tyre, sipas përcaktimeve në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 7 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” (në vijim “udhëzimi nr. 4095/2016 i ILDKPKI-së”).

¹⁵ I dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2019, të ILDKPKI-së.

¹⁶ Në përgjigje të pyetjes së Komisionit se në llogarinë bankare të tij në {***}, znj. M. D. kishte derdhur shumën prej 1.400.000 lekësh, e tërhequr brenda ditës prej subjektit të rivlerësimit.

9.1.5. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të burimit të krijimit të apartamentit në Shkodër në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me burimet e përdorura për financimin e kësaj të parë të çmimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

9.2. Lidhur me huan prej 30.000 eurosh, marrë nga z. E. R. në vitin 2006, Kolegji vëren se në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, bashkë me pretendimin për herë të parë kësaj huaje, ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 01.11.2019, të z. E. R.¹⁷, sipas të cilit në dhjetor 2006 i kishte dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 30.000 eurosh, me burim të ardhurat si ortak i shoqërisë “{***}” ShPK, dhe ai i kishte kthyer shumën prej 1.400.000 lekësh në dhjetor 2007, ndërsa pjesën e mbetur në maj 2008.

9.2.1. Kolegji, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme¹⁸, konstaton se deklaratimet e z. E. R., janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për efekt të tij dhe, për rrjedhojë, vlera e tyre provuese, e pambështetur me prova të tjera, mbetet e kufizuar. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se bazuar në parashikimet e nenit 49, pika 1, germa “b” dhe pika 4 e ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e z. E. R. nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me deklaratën fillestare 2012 në ILDKPKI dhe as me procesverbalin e datës 15.04.2016 të ILDKPKI-së, në të cilat huaja prej 30.000 eurosh nga z. E. R. nuk rezulton e deklaruar si burim të ardhurash dhe, për mbi të gjitha, nuk rezulton të jetë e deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, rrethana që dobësojnë ndjeshëm vlerën e tyre provuese në kuptim të këtij procesi.

9.2.2. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm rreth besueshmërisë së ekzistencës së marrëdhënies së mësipërme të huas, Kolegji, në përgjigje të shkaqeve të ankimit, verifikoi edhe justifikimin me burime të ligjshme të huas prej 30.000 eurosh, marrë nga z. E. R.. Rezulton se, pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratat e tatimit mbi fitimin të shoqërisë “{***}” ShPK për vitin 2005, në shumën prej 15.774.685 lekësh¹⁹, dhe për vitin 2006 në shumën prej 19.386.986 lekësh²⁰, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 01.10.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër (në vijim “DRTSh”)²¹.

9.2.2.1. Kolegji vëren se nga deklaratat e tatimit mbi fitimin të shoqërisë “{***}” ShPK për vitin 2005 - 2006, nuk rezulton shpërndarje dividendi dhe as ndonjë marrëdhënie që të legjitimonte në ndonjë mënyrë përdorimin/zotërimin e shumave të shoqërisë “{***}” ShPK prej ortakut të saj, z.

¹⁷ Deklarata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2019.

¹⁸ Vendimet nr. 23/2020(JR), nr. 34/2019(JR), nr. 3/2021(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁹ Përkatësisht, fitimi i tatueshëm neto 15.774.685 lekë, tatim fitimi 3.628.178 lekë, ndërsa fitimi neto 12.146.507 lekë.

²⁰ Përkatësisht, fitimi i tatueshëm neto 19.386.986 lekë, tatim fitimi 3.877.397 lekë, ndërsa fitimi neto prej 15.509.589 lekësh.

²¹ Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, pas rezultateve të hetimit, ka paraqitur edhe: a) licencën {***}, datë 06.12.2010, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (në vijim “MPPT”), të vlefshme deri në datën 21.07.2019, për punime ndërtimore në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; b) ekstraktin e regjistrimit të shoqërisë “{***}” ShPK; c) vërtetimin nr. {***} prot., datë 12.01.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, se shoqëria “{***}” ShPK nuk kishte detyrime tatimore të pashlyera.

E. R.. Në përputhje me jurisprudencën e deritanishme²², Kolegji vlerëson se të ardhurat e huadhënësit, të pretenduara prej subjektit, edhe sikur të ishin deklaruar saktësisht e plotësisht sipas parashikimeve ligjore, nuk plotësojnë kriterin e së ardhurës së ligjshme të parashikuar nga neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, do ta vinin subjektin në kushtet e mosjustifikimit me burime të ligjshme të krijimit të huas prej 30.000 eurosh nga z. E. R. në vitin 2006, duke rënë ndesh në këtë mënyrë me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

9.2.2.2. Duke mos konsideruar huan nga z. E. R., Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar pagimin e këstit të parë prej 30.000 eurosh, të pasurisë apartament.

9.3. Për sa i përket huas prej 1.400.000 lekësh nga znj. M. D., përgjatë hetimit paraprak, Komisioni kishte konstatuar se në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në {***}, në datën 18.12.2007, znj. M. D. kishte derdhur shumën prej 1.400.000 lekësh, shumë e cila ishte tërhequr brenda ditës nga subjekti i rivlerësimit. Rezulton se, në shpjegimet e dhëna në Komision në datën 09.04.2019, përgjatë hetimit paraprak, në vijim të konstatimit të Komisionit, subjekti ka deklaruar se këtë shumë e ka marrë me qëllim që të paguante një kësht për *prenotimin* e banesës në Shkodër, ndërsa pas njohjes me rezultatet e hetimit, ka deklaruar në mënyrë të ndryshme se huan nga znj. M. D. e kishte marrë për të shlyer një pjesë të huas nga z. E. R.. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 05.04.2019, të znj. M. D.²³, e cila deklaron se në datën 18.12.2007, i kishte dhënë subjektit të rivlerësimit huan prej 1.400.000 lekësh nëpërmjet {***}, Dega Lezhë, të cilën ia kishte kthyer në *cash* në datën 02.05.2008, dhe se e kishte depozituar po në të njëjtën datë në llogarinë e saj pranë kësaj banke.

9.3.1. Nga nxjerrja e llogarisë së znj. M. D. në {***}, Dega Lezhë, rezulton se në datën 18.12.2007, ajo ka tërhequr nga kjo llogari shumën prej 1.400.000 lekësh, dhe në datën 02.05.2008 ka depozituar të njëjtën shumë.

9.3.2. Kolegji vëren se në llogarinë e znj. M. D., në {***}, Dega Lezhë, në datën 18.12.2007 është kryer veprimi me përshkrimin: “[...] M. D. [...] tërheqje nga llog. - 1.400.000 lekë [...]”, dhe po në datën 18.12.2007, në {***}, Dega Shkodër, janë kryer veprimet “[...] arkëtuar në llog. nga M. D.” dhe “[...] Simon D. Pashuku tërheq nga llogaria [...]”.

9.3.3. Nga aktet e sipërcituara, rezulton se shuma prej 1.400.000 lekësh është tërhequr nga znj. M. D. *cash* nga llogaria e saj në {***}, Dega Lezhë, dhe është depozituar po *cash* në {***}, Dega Shkodër, në llogari të subjektit të rivlerësimit.

9.3.4. Kolegji vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe deklarimi përgjatë hetimit të Komisionit të huas prej 1.400.000 lekësh, të marrë nga znj. M. D. në vitin 2007, si burim të shlyerjes së pjesës së huas prej 30.000 eurosh nga z. E. R. të marrë në vitin 2006, në funksion

²² Vendimi nr. 31/2021(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²³ Deklarata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.04.2019.

të pagimit të këstit të parë të apartamentit me sip. 120 m², në rr. “{***}”, Shkodër, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

9.3.5. Lidhur me justifikimin me burime të ligjshme të huas prej 1.400.000 lekësh nga znj. M. D., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kontratë shitje pasurie të paluajtshme, datë 05.12.2001, në çmimin 2.000.000 lekë, ku znj. M. D. ishte bashkëpronare me 1/3 dhe dëshminë e trashëgimisë së çelur për bashkëpronarët e tjerë (prindërit) në vitet 2004 dhe 2006, trashëgimtare e të cilëve ishte po znj. M. D.²⁴. Nga nxjerrja e llogarisë në lekë të znj. M. D. në {***}, rezulton se në datën 11.09.2007, në llogarinë në monedhën *lekë*, ajo ka kryer veprimin me përshkrim “[...] derdh. në dep. të ardhura nga shitje toke [...] 2.000.000 [...]”.

9.3.6. Këto të ardhura rezulton se janë depozituar në depozitën bankare në datën 11.09.2007, me burim krijimi një kontratë shitje që është lidhur në 05.12.2001, pra shumë kohë përpara se të ardhurat të depozitoheshin në bankë, duke e bërë të vështirë besueshmërinë e krijimit të kësaj pasurie sipas kësaj forme. Përveç sa më lart, nga aktet e administruara, rezulton se znj. M. D. në datën 21.09.2007, ka kryer një tjetër depozitim, në llogarinë e saj në {***}, në shumën prej 1.800.000 lekësh²⁵. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se dokumentet e mësipërme nuk janë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se burimi i huas prej 1.400.000 lekësh, marrë nga znj. M. D. në vitin 2007, ishte çmimi i shitjes prej 2.000.000 lekësh, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme në vitin 2001.

9.3.7. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se të ardhurat e huadhënëses, të pretenduara prej subjektit, edhe sikur të ishin deklaruar saktësisht e plotësisht sipas parashikimeve ligjore, nuk arrijnë të kalojnë testin e besueshmërisë për krijimin me burime të ligjshme, për shkaqet e përshkruara më lart, dhe duket se nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

9.3.8. Në konkluzion, lidhur me huan prej 30.000 eurosh nga z. E. R. në vitin 2006, të deklaruar se është marrë për pagimin e këstit të parë, dhe huan prej 1.400.000 lekësh, të deklaruar se është marrë nga znj. M. D. në vitin 2007, për shlyerjen së huas të vitit 2006, Kolegji vlerëson se, së pari, ato mbeten në nivel deklarativ dhe nuk krijojnë bindjen se janë përfituar prej tij sipas pretendimeve, por edhe sikur të ishin të besueshme, duket se subjekti nuk arrin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të përdorura për krijimin e tyre në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, të ardhurat e pretenduara të përfituara

²⁴ Përkatësisht: a) kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme tokë arë nr. {***} rep. nr. {***} kol. datë 05.12.2001, shitës z. A. D., znj. M. D. dhe znj. M. D., dhe blerës z. A. E., sipas të cilës: “Pala blerëse ia shet këtë pasuri palë blerëse kundrejt vlerës 2.000.000 lekë të reja (dy milion). Pala blerëse e ka pranuar blerjen e kësaj pasurie në shumën e mësipërme, dhe se e ka likuiduar palë shitëse tërësisht jashtë kësaj zyre.”; dhe b) vendimin nr. {***}, datë 26.12.2006 të GjRrGjL-së, nëpërmjet të cili sipas është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin, z. A. D., i cili kishte vdekur në datën 20.09.2006, dhe trashëgimlënësen, znj. M. D., e cila kishte vdekur në datën 20.08.2004, duke përcaktuar si dëshmitare të radhës së parë, znj. M. D..

²⁵ Përkatësisht: “[...] derdh në dep. fleksibël të ardhura nga shitje toke [...]”, për të cilat nuk ka një shpjegim lidhur me burimin.

prej këtyre huave, nuk mund të përdoren për të justifikuar pagimin e këstit të parë të apartamentit në vitin 2006.

9.4. Në deklaratën *vetting*, si burim krijimi të apartamentit në rr. “{***}”, Shkodër, në vlerën prej 60.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe dhurimet në vitin 2008, nga: a) vëllai, z. F. P., në shumën prej 20.000 eurosh; b) motra, znj. N. P., në shumën prej 8.000 eurosh; c) motra, znj. M. B., në shumën prej 5.000 eurosh; dhe ç) motra, znj. M. L., në shumën prej 5.000 eurosh.

9.5. Për sa i përket dhurimit prej 20.000 eurosh, nga vëllai F. P., Kolegji vëren se, së bashku me deklaratën *vetting*, gjatë shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI në datën 15.04.2016 dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision në datën 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me dorëshkrim, datë 08.04.2016, të z. F. P., i cili ka deklaruar se i kishte dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 20.000 eurosh në vitin 2008, për blerje banese në Shkodër.

9.5.1. Për sa i përket justifikimit me burime të ligjshme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ekstraktin e llogarisë së sigurimeve të lëshuar në shtetin italian, në datën 24.05.2019, për z. F. P. dhe znj. N. P..

9.5.1.1. Kolegji kreu analizën e mundësisë së kursimit të z. F. P. dhe znj. N.P., si më poshtë, bazuar në aktet e administruara në dosje për periudhën korrik 1999 deri në fund të vitit 2007.

9.5.1.1.1. Të ardhurat e z. F. P. dhe znj. N. P., për periudhën e mësipërme, rezultuan në shumën totale prej 179.866 euro²⁶. Duke u zbritur të ardhurave më sipër shpenzimet familjare për dy persona²⁷ për periudhën nga korrik 1999 - 31.12.2007, në shumën prej 123.198 eurosh, familja do të kishte pasur mundësi të kursente vlerën prej 56.668 eurosh²⁸.

9.5.1.2. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit provoi që z. F. P., në përputhje me nenin 32, pika 4, ka justifikuar ligjshmërinë e burimit të dhurimit prej 20.000 eurosh në vitin 2008.

9.6. Për sa i përket dhurimit prej 5.000 eurosh, nga motra M. L., Kolegji vëren se së bashku me deklaratën *vetting*, gjatë shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, në datën 15.04.2016 dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision në datën 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me dorëshkrim të datës 08.04.2016, të znj. M. L., e cila ka deklaruar se i kishte dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 5.000 eurosh në vitin 2008, për blerje banese në Shkodër.

9.6.1. Për sa i përket justifikimit me burime të ligjshme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ekstraktin e llogarisë së sigurimeve, të lëshuar në shtetin italian, në datën 24.05.2019, për znj. M. L. dhe z. F. L..

²⁶ Përkatësisht: a) të ardhurat sipas ekstraktit INPS - Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, datë 24.05.2019, për z. F. P. dhe znj. N. P., nga korrik 1999 deri në fund të vitit 2006; b) të ardhurat nga formularët CUD për vitin 2007 për znj. N. P.²⁶ dhe për vitin 2007 për F. P.²⁶.

²⁷ Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësor, deri në vitin 2008 kanë qenë vetëm dy persona.

²⁸ Shpenzimet e jetesës, Kolegji i ka konsideruar sipas të dhënave të Eurostat për person, në nivelin e varfërisë në Itali (at-risk-of-poverty):

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01__custom_1445600/settings_1/table?lang=en.

9.6.1.1. Kolegji kreu analizën e mundësisë së kursimit të znj. M. L. dhe z. F. L., si më poshtë, bazuar në aktet e administruara në dosje për periudhën tetor 2006 deri në fund të vitit 2008.

Të ardhurat e znj. M. L., nga data 12.10.2006, kur ka filluar të gjenerojë të ardhura, deri në fund të vitit 2008, Kolegjit i rezultuan në shumën prej 33.028 eurosh. Duke u zbritur të ardhurave më sipër shpenzimet familjare për dy persona, për periudhën nga tetor 2006 - 31.12.2008, në vlerën prej 41.264 eurosh²⁹, familja nuk do të kishte pasur mundësi të krijonte kursime³⁰.

9.6.1.2. Në këto kushte, në përfundim të analizës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se znj. M. L. kishte burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e shumës prej 5000 eurosh, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar nga nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

9.7. Për sa i përket dhurimit prej 8.000 eurosh, nga motra N. P., Kolegji vëren se, së bashku me deklaratën *vetting*, gjatë shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI në datën 15.04.2016 dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision në datën 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me dorëshkrim, datë 08.04.2016, të znj. N. P., e cila ka deklaruar se i kishte dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 8.000 eurosh në vitin 2008, për blerje banese në Shkodër.

9.7.1. Për sa i përket justifikimit me burime të ligjshme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ekstraktin e llogarisë së sigurimeve, të lëshuar në shtetin italian, në datën 24.05.2019, për znj. N. P., si dhe kontratën e qëndrimit për punë shtëpiake, datë 17.12.2002, me pagë 700 euro/muaj, si dhe formularët CUD të të ardhurave për vitet 2003 - 2008.

9.7.1.1. Kolegji kreu analizën e mundësisë së kursimit të znj. N. P., si më poshtë, bazuar në aktet e administruara në dosje, për periudhën qershor 2002 deri në fund të vitit 2008.

9.7.1.1.1. Të ardhurat e znj. N. P., për periudhën qershor 2002 - 31.12.2008, sipas të dhënave të INPS - Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, Kolegjit i rezultojnë në shumën totale prej 45.888 eurosh, ndërsa sipas të dhënave në formularët CUD, për periudhën 2003 - 2008, rezultojnë në shumën totale prej 54.684 eurosh. Duke u zbritur të ardhurave më sipër shpenzimet familjare për një person, për periudhën nga qershori 2002 - 31.12.2008, prej 53.307 eurosh, Kolegjit i rezulton se znj. N. P. nuk do të kishte mundësi për të krijuar kursime, duke konsideruar të ardhurat

²⁹ Përkatësisht: a) të ardhurat sipas ekstraktit INPS - Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, datë 27.05.2019, për z. F. L., për periudhën nga data 01.10.2007 deri në fund të vitit 2008²⁹; b) të ardhurat nga skedat e pagave neto mujore të znj. M. L., si në vijim: i) për vitin 2006, periudha tetor - dhjetor 2006, në vlerën prej 1.688 eurosh; ii) për vitin 2007, periudha janar - dhjetor 2007, në vlerën prej 8.206 eurosh; dhe iii) për vitin 2008, periudha janar - dhjetor 2008, në vlerën prej 10.690 eurosh.

³⁰ Shpenzimet e jetesës, Kolegji i ka konsideruar sipas të dhënave të Eurostat për person në nivelin e varfërisë në Itali (*at-risk-of-poverty*), përkatësisht: a) në vlerën prej 8.736 eurosh/vit për vitin 2006; b) në vlerën prej 9.064 eurosh/vit për vitin 2007; dhe c) në vlerën prej 9.384 eurosh/vit për vitin 2008. Duke konsideruar në analizën financiare edhe shpenzimet e jetesës për vajzën e lindur në datën 29.07.2005, shpenzimet e jetesës do të rriteshin edhe më tej duke thelluar mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar dhurimin në vitin 2008.

sipas të dhënave nga INPS - Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore³¹. Nëse në funksion të një analize garantuese dhe shteruese për periudhën nga 2003 – 2008, do të konsideroheshin të ardhurat sipas formularëve të CUD, prej të cilave do të zbriteshin shpenzimet për të njëjtën periudhë, prej 50.187 eurosh, mundësia e kursimit të znj. N. P. do të rezultonte në shumën prej 4.497 eurosh, e pamjaftueshme për të justifikuar dhurimin e gjithë shumës prej 8.000 eurosh.

9.7.1.1.2. Nëse do të konsideroheshin në analizën financiare edhe shpenzimet e jetesës për vajzën e lindur në datën 19.03.1998, shpenzimet e jetesës do të rriteshin edhe më tej duke thelluar mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar dhurimin në vitin 2008.

Në këto kushte, në përfundim të analizës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se znj. N. P. kishte burime të ligjshme për të krijuar të gjithë shumën prej 8000 eurosh, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

9.8. Për sa i përket dhurimit prej 5.000 eurosh, nga motra M. B., Kolegji vëren se, së bashku me deklaratën *vetting*, gjatë shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI në datën 15.04.2016 dhe gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision në datën 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me dorëshkrim, datë 08.04.2016, të znj. M. B. dhe z. A. B., të cilët kanë deklaruar se i kishin dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 5.000 eurosh në vitin 2008, për blerje banese në Shkodër.

9.8.1. Për sa i përket justifikimit me burime të ligjshme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ekstraktin e llogarisë së sigurimeve, të lëshuar në shtetin italian, në datën 23.05.2019, për znj. M. B. dhe z. A. B., së bashku me formularët CUD të të ardhurave për vitet 2006 – 2008, për bashkëshortin e së motrës së subjektit të rivlerësimit, z. A. B., dhe për motrën e subjektit, për vitet 2006 dhe 2008, si dhe skedën e pagave neto mujore të z. A. B. për muajin dhjetor 2006, për periudhën janar - dhjetor 2007, dhe periudhën janar - dhjetor 2008.

9.8.1.1. Kolegji kreu analizën e mundësisë së kursimit të znj. M. B. dhe z. A. B., si më poshtë, bazuar në aktet e administruara në dosje, për periudhën janar 2006 deri në fund të vitit 2008. Të ardhurat e znj. M. B. dhe z. A. B. për periudhën janar 2006 deri në fund të vitit 2008, Kolegjit i rezultuan në shumën totale prej 66.139 eurosh³². Duke zbritur nga të ardhurat më sipër, shpenzimet familjare për familje me dy persona e dy fëmijë poshtë moshës 14 vjeç, për vitet 2006 - 2008, në vlerën prej 57.086 eurosh, familja do të kishte pasur mundësi kursimi të vlerës prej 9.053 eurosh³³.

³¹ Shpenzimet e jetesës, Kolegji i ka konsideruar sipas të dhënave të Eurostat për person në nivelin e varfërisë në Itali. (*at-risk-of-poverty*):

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01__custom_1445600/settings_1/table?lang=en.

³² Përkatësisht: a) të ardhura sipas të dhënave nga formularët CUD për vitin 2006, për znj. M. B., në vlerën prej 8027.78 eurosh, duke zbritur tatimet prej 821,9 eurosh, ndërsa për z. A. B. në vlerën prej 22370,4 eurosh, duke zbritur tatimet prej 2551,22 eurosh; b) të ardhurat nga skedat e pagave neto mujore të z. A. B. për periudhën janar - dhjetor 2007, në vlerën prej 21.344 eurosh; dhe c) të ardhurat sipas formularëve CUD për vitin 2008, për znj. M. B., në vlerën prej 2450.94 eurosh, duke zbritur tatimet në vlerën prej 262,14 eurosh, ndërsa për z. A. B., në vlerën prej 15910,47 eurosh, duke zbritur tatimet në vlerën prej 329,86 eurosh.

³³ Shpenzimet e jetesës janë konsideruar sipas të dhënave të Eurostat për familje me dy fëmijë nën 14 vjeç (lindur në datën 27.02.2003 dhe datën 15.02.2004) në nivelin e varfërisë në Itali, përkatësisht: a) në vlerën prej 18.346 eurosh/vit

9.8.1.2. Në këto kushte, Kolegjit i rezultoi se znj. M. B. dhe z. A. B., në përputhje me nenin 32, pika 4, kanë justifikuar ligjshmërinë e burimit të dhurimit prej 5.000 eurosh në vitin 2008.

9.8.2. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte burimin e ligjshëm të krijimit për dy nga dhurimet e familjarëve të tij, të shumës prej 5000 eurosh, të dhënë hua prej motrës N. P., dhe të gjithë shumës prej 8000 eurosh, të dhënë hua nga motra M. L..

9.9. Për sa i përket dhurimit prej 3.000 eurosh, dhënë në vitin 2008 nga vjehri, z. J. M., Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar atë si burim të krijimit të pasurisë apartament në Shkodër, në deklaratën *vetting*. Pavarësisht pasaktësisë së deklaramit në deklaratën *vetting*, në dokumentet shoqëruese të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me dorëshkrim, datë 09.04.2016, të z. J. M.³⁴. Gjithashtu, gjatë shpjegimeve në IKDKPKI të datës 15.04.2016, është deklaruar ky dhurim, i shoqëruar edhe me deklaratën me dorëshkrim, datë 09.04.2016, të z. J. M..

9.9.1. Lidhur me justifikimin me burime të ligjshme të huas prej 3.000 eurosh, gjatë shpjegimeve në Komision, në datën 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur nxjerrjen e llogarisë së përbashkët të z. I. M. dhe z. J. M. nga {***}.

9.9.1.1. Sipas aktit të mësipërm, rezulton se, në datën 21.04.2006, z. J. M. kishte tërhequr shumën e mbetur në këtë llogari, prej 2.569.155 lekësh, prej së cilës, sipas pretendimit të subjektit, është përftuar edhe shuma prej 3000 eurosh, dhënë atij dhuratë në vitin 2008. Kjo rrethanë si e vetme, përfshirë këtu edhe faktin se llogaria nga e cila është tërhequr shuma gjendet në emër jo vetëm të vjehrit të subjektit, por edhe të djalit të tij, në vlerësim edhe të distancës kohore nga tërheqja e kësaj shume deri te dhënia e saj dhuratë, edhe në vlerësimin e Kolegjit nuk krijon bindjen për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj si në pikëpamje faktike, pra nëse kjo shumë e tërhequr prej llogarisë ka shërbyer për krijimin e shumës prej 3000 eurosh, por edhe në pikëpamje të ligjshmërisë së vetë shumës së tërhequr prej llogarisë, për të cilën nuk identifikohen burimet e ligjshme.

9.9.2. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 3000 eurosh, deklaruar si dhurim prej vjehrit të tij sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

9.10. Në përmbyllje të vlerësimit e kontrollit që iu bë pasurisë apartament, të ndodhur në Shkodër, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në analizë të shkaqeve të ankimit, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për financimin e kësaj të parë të tij në vitin 2006, në vlerën prej 30.000 eurosh. Mungesa e deklaramit të saktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, për sa u përket huave të dhëna nga z. E. R. dhe

për vitin 2006; b) në vlerën prej 19.034 eurosh/vit për vitin 2007; dhe c) në vlerën prej 19.706 eurosh/vit për vitin 2008: [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_1895027/default/table?lang=en].

³⁴ I cili ka deklaruar se i kishte dhuruar në vitin 2008, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, shumën prej 3.000 eurosh për blerje banese në Shkodër.

znj. M. D., si dhe në deklaratën fillestare në vitin 2012, të cilat janë deklaruar si të tilla vetëm pas kalimit të barrës së provës, në momentin kur Komisioni kishte përfunduar raportin paraprak të hetimit, mungesa e konsistencës së deklarimeve për kronologjinë dhe rendin e veprimeve financiare lidhur me to, mungesën e provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e tyre nga këta shtetas, edhe në versionin se do të pranoheshin këto hua si burime financimi, mungesën e provueshmërisë së një pjese të shumave të dhuruara prej familjarëve të tij, që deklarohet se kanë shërbyer për shlyerjen e huave, tregojnë sipas një vlerësimi tërësor të të gjitha hallkave të zinxhirit të burimeve të pretenduara, të kryer nga Kolegji, se, pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë se burimet për pagimin e këstit të parë të apartamentit kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84.2016.

9.11. Në përfundim, lidhur me pasurinë apartament me sip. 120 m², ndodhur në rr. “{***}”, Shkodër, Kolegji vlerëson se:

- a) subjekti i rivlerësimit, duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimet e përdorura për financimin e këstit të parë të çmimit të kësaj pasurie, paguar sipas kontratës së sipërmartjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 07.12.2006, ka kryer deklaram të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- b) subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar pagimin e këstit të parë të pasurisë apartament, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

B.2. Lidhur me ndërtesën dhe pistën në fshatin {*}**

10. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndërtesën me sip. 56 m² dhe pistën me sip. 40 m², në fshatin {***}, Shkodër, në proces legalizimi, të ndërtuar së bashku me vëllain, z. F. P., me burim krijimi të ardhurat nga paga dhe të ardhurat e vëllait.

10.1. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të tyre, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke bërë për Komisionin deklaram të pamjaftueshëm, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016

10.2. Në deklaratën fillestare 2012 në ILDKPKI, ka deklaruar sipërfaqen 100 m², ndërsa pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e investimit kishte qenë rreth 300.000 lekë.

10.2.1. Pas kalimit të barrës së provës sepse: a) nuk kishte deklaruar vlerën e investimit; b) kishte mospërputhje të deklarimeve për bashkëpronësinë me vëllain, për arsye se nga hetimi kishte rezultuar se aplikimi dhe e gjithë korrespondenca me ALUIZNI-n ishte kryer nga dhe drejt subjektit; c) kishte mungesë të dokumentacionit provues ligjor për burimin e krijimit dhe pjesën takuese të investimit; dhe ç) kishte të dhëna kontradiktore në lidhje me sipërfaqen e saktë të këtij ndërtimi, investimin, si dhe vitin e ndërtimit të objektit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur raportin

e vlerësimit, datë 30.10.2019³⁵, sipas të cilit vlera e punimeve të objektit njëkatësh, me sipërfaqe 56,16 m² dhe pistë betoni me sipërfaqe prej 50 m², ndërtuar në vitin 2001, ka kushtuar 318.347 lekë, prej së cilës, për ndërtesën 287.247 lekë dhe për pistën e betonit 31.100 lekë.

10.3. Për sa i përket vlerës së investimit, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme³⁶, duke u gjendur në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues, Kolegji kreu llogaritjen sipas standardeve të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), të cilat parashikojnë koston mesatare të ndërtimit, e përcaktuar ndër vite prej EKB-së, që sipas praktikës së Kolegjit, janë çmuar si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, të sjellë prej subjektit të rivlerësimit.

10.3.1. Llogaritja e vlerës së investimit të ndërtesës me 56,16 m², sipas standardeve të EKB-së për kostot e ndërtimit për vitin 2001, ndryshe nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, Kolegjit i rezultoi në vlerën prej 1.379.476 lekësh, për sa më poshtë.

10.3.2. Duke konsideruar koston e ndërtimit për rrethin e Shkodrës, sipas udhëzimit nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K” të Këshillit të Ministrave, për vitin 2001, sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit³⁷ në ILDKPKI në datën 15.04.2016, dhe sipas raportit të vlerësimit, datë 30.10.2019, Kolegjit i rezultoi që kostoja mesatare e ndërtimit të ketë qenë 27.073 lekë/m² për sipërfaqe ndërtimi.

10.3.3. Duke konsideruar sipërfaqen e ndërtimit prej 56,16 m², sipas konstatimeve të ALUIZNI-t për objektin 1-katësh, vlera e ndërtimit do të ishte 1.520.419 lekë. Nëse nga kjo vlerë do të zbritet vlera e fitimit të planifikuar dhe e fondit rezervë, në masën 9,27 %³⁸ të koston së ndërtimit, vlera e ndërtimit për m² do ishte 24.563 lekë/m² dhe vlera e ndërtimit do të ishte 1.379.476 lekë.

10.4. Për sa i përket pretendimit se ndërtimi ishte kryer me burime të përbashkëta me vëllain, z. F. P., i cili ishte edhe bashkëpronar në këtë ndërtesë, për shkak të bashkëpronësisë mbi truallin, Kolegji, vlerëson se fakti i vetëm i bashkëpronësisë mbi truallin, e bënte bashkëpronar vëllain e tij edhe në objektin e ndërtuar mbi të, sidomos për sa i përket ndarjes së investimeve, nuk është në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, në kundërshtim me parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

10.4.1. Bashkëpronësia e vëllait mbi tokën nuk ka ndonjë efekt në përlllogaritjen e shpenzimeve për ndërtimin e objektit. Duke renditur rrethanat që rezultojnë nga deklaratimet e mëparshme që subjekti i rivlerësimit ka kryer në ILDKPKI, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën fillestare të pasurisë 2012, në ILDKPKI, nuk e ka deklaruar vëllain si bashkinvestues, dhe gjithashtu nuk e ka deklaruar si të tillë edhe gjatë shpjegimeve në ILDKPKI, në datën 15.04.2016³⁹.

³⁵ Përgatitur nga ing. B. B..

³⁶ Vendimet nr. 15/2019(JR), nr. 31/2021(JR) dhe nr. 34/2021(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³⁷ Të dorëzuar në Komision nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 07.06.2019, të ILDKPKI-së.

³⁸ Sipas shkresave nr. {***} prot., datë 13.10.2021 dhe nr. {***} prot., datë 21.10.2021 të EKB-së, përkatësisht: 100 % - 9,27% x 27.073 lekë/m².

³⁹ Përkatësisht, duke deklaruar se: “Po paraqes foto aktuale nga ndërtesa për të cilën është aplikuar tek ALUIZNI dhe të cilën e kam deklaruar”. Dhe se: “Aktivitetin në foto e ka shtetasi N. P., i cili ka pasur marrëdhënie me mua nga viti 2006 deri në fund të vitit 2012, kohë kur unë i kisha dhënë me qira objektin dhe tokën përreth. Në fillim të vitit 2013, unë këtë ndërtesë dhe marrëdhëniet që ka shtetasi N. P., ia kam kaluar vëllait tim F. P. [...]”.

10.4.2. Nga ana tjetër, vetëdeklarimi për legalizim objekti, i regjistruar pranë ALUIZNI-t me nr. {***}, datë 06.11.2006, i cili është nënshkruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit, është akt zyrtar, me vlerë provuese, që vërteton posedimin mbi ndërtimin pa leje, në kuptim të nenit 2, pikat 1 e 2 të nenit 3, germa “g” dhe 7, pika 1 e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (në vijim “ligji nr. 9482/2006”).

10.5. Për sa më lart, Kolegji, duke konsideruar konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri, të cilat janë të drejtuara në mënyrë empirike drejt mungesës së burimeve të ligjshme, por pa përcaktuar një vlerë si për koston e ndërtimit, ashtu edhe për mungesën e burimeve, si dhe duke analizuar të gjitha rrethanat që lidhen me këtë pasuri, si: i) faktin se ndërtimi është bërë në një kohë të largët; ii) në një zonë rurale; iii) nuk duket se ka të gjitha elementet e një ndërtimi të mirëfilltë në kuptim të ndërtimit, vlera e të cilit përcaktohet nëpërmjet zbatimit të çmimeve referuese të EKB-së, arriti në konkluzionin se lidhur me këtë pasuri, duhet konfirmuar vetëm qëndrimi që Komisioni ka mbajtur drejt deklarimit të pasaktë të subjektit. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë ndërtesë me sip. 56 m² dhe pistë me sip. 40 m², në fshatin {***}, Shkodër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke mos deklaruar në përputhje me detyrimin ligjor në të, vlerën e kësaj pasurie, rrethanë që e vendos në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

B.3. Lidhur me llogaritë bankare dhe gjendjen *cash*

11. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë bankare në {***}, me vlerë prej 20.000 eurosh, një llogari bankare në {***}, me vlerë prej 11.054 eurosh, dhe gjendjen *cash* prej 1.200.000 lekësh, me burim krijimi nga qiraja e ndërtesës në fshatin {***} për depozitën dhe llogarinë bankare, ndërsa për gjendjen *cash*, përveç qirasë së ndërtesës në fshatin {***}, si burim janë deklaruar edhe kursimet familjare. Gjithashtu, në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja me qiramarrësin, z. N. P., të ndërtesës në fshatin {***}, prej 60.000 lekësh/muaj, për periudhën mars 2006 - dhjetor 2012, duke paguar tatimfitimin, sipas mandatpagesës së datës 24.10.2016 nga {***}.

11.1. Në deklaratën fillestare 2012 në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar qira ndërtesë, 60.000 lekë/muaj, për periudhën mars 2006 - dhjetor 2012, dhe gjendje *cash* 40.000 euro.

11.2. Për sa i përket depozitës në {***}⁴⁰, rezulton se ajo është çelur nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. E. P. në datën 08.10.2016, në të cilën është kredituar shuma prej 20.000 eurosh, për të cilën nuk rezulton përshkrimi mbi transaksionin.

11.2.1. Për sa i përket llogarisë në {***}⁴¹, rezulton se është çelur nga subjekti i rivlerësimit në datën 12.08.2005, në të cilën, përveç disbursimit të kredisë prej 25.000 eurosh në datën 29.04.2008, në llogari janë kryer disa kreditime, prej të cilave nuk rezulton burimi i krijimit, përveç shumës prej 12.000 eurosh, të kredituar në këtë llogari në datën 10.10.2016 nga subjekti i rivlerësimit, sipas përshkrimit të të cilit kishin për burim krijimi të ardhurat nga kursimet e familjes.

⁴⁰ Llogaria nr. {***}, sipas shkresave nr. {***} prot., datë 21.07.2017 dhe nr. {***} prot., datë 29.06.2018 të {***}.

⁴¹ Llogaria nr. {***}, sipas shkresave nr. {***} prot., datë 06.07.2017 dhe nr. {***} prot., datë 16.04.2018 të {***}.

11.3. Kolegji konstaton se nuk gjendet asnjë gjurmë dokumentare e kohës që të provojë ekzistencën e marrëdhënies së qirasë, kohëzgjatjen apo shpërblimin për qiranë mujore të pretenduar, si edhe vetë përfitimin e shumës prej 40.000 eurosh.

11.3.1. Sipas pikës 2.3.6, paragrafi i fundit, të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të ministrit të Financave (në vijim “udhëzimi nr. 5/2006 i MF-së”): “Llogaritja e detyrimit tatimor për këtë kategori të ardhurash do të bëhet duke u bazuar në kontratën përkatëse”.

11.3.2. Për këtë arsye, agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”) dhe të nenit 7, pika 2, germa “a” e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përveç se ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues, ka edhe detyrat plotësuese: “a) të llogaritë saktësisht dhe të mbajë tatimin për një tatimpagues; b) të paguajë tatimin në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj; c) të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura të të gjithë tatimpaguesve dhe të pagesave, të transferuara në Buxhetin e Shtetit; ç) t’i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur, të përcaktuar në ligj [...]”.

11.3.3. Bazuar në nenin 64, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 9920/2008, që parashikojnë se: “1). Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës. 2). Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore”, marrëdhënia e qirasë, pavarësisht formës së lidhjes, formalizohet me akt zyrtar, për efekt të pagimit të detyrimit tatimor.

11.3.4. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të vërtetuar marrëdhënien e qirasë nëpërmjet deklaratës nr. {***} rep., datë 21.10.2016⁴², mbetet në nivel deklarativ, i pambështetur në dokumentacion ligjor dhe nuk është në përputhje me parashikimet e neneve 33 e 64, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 8438/1998 të, nenit 7, pika 2, germa “a” e ligjit nr. 9920/2008, si dhe të udhëzimit nr. 5/2006 të MF-së, pika 2.3.6.

11.4. Për sa i përket pretendimit se ndërtesa ishte dhënë me qira për aktivitet tregtar, ky pretendim është në kundërshtim me të dhënat e regjistrimit tregtar, pasi sipas certifikatës së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (në vijim “QKR”), subjekti tregtar N. P., person fizik, e ka filluar aktivitetin në vitin 2015, disa vite pas marrëdhënies së qirasë së pretenduar për periudhën 2006 - 2012.

11.4.1. Dokumentet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si faturat tatimore të shitjes së mermerit/granitit⁴³, nga shitësi “{***}” ShPK, blerësit N. P. deri në vitin 2014, dhe subjekti tregtar N. P., person fizik për periudhën 2014 - 2017, që dëshmojnë transaksionin e shitblerjes

⁴² Sipas së cilës ishte qiradhënie nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2006 - 2012, dhe në vazhdimësi prej vitit 2013 nuk ka paguar asnjë vlerë ndaj pronarit të objektit.

⁴³ Përkatësisht nr. {***}, datë 11.08.2010; nr. {***}, datë 14.09.2010; nr. {***}, datë 11.03.2011; nr. {***}, datë 02.08.2012; nr. {***}, datë 26.09.2012; nr. {***}, datë 20.06.2014; nr. {***}, datë 04.05.2016; nr. {***}, datë 27.01.2016; nr. {***}, datë 28.11.2016; nr. {***}, datë 09.05.2011; nr. {***}, datë 07.07.2017; nr. {***}, datë 13.10.2017; nr. {***}, datë 11.03.2011.

(sipas rastit, individit apo subjektit tregtar) apo, si libreza e energjisë elektrike nr. {***}, nga e cila rezultojnë pagesa për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2015, 2016, që dëshmon përdorimin e sendit të paluajtshëm në adresën “{***}”, janë rrethana të cilat, bazuar në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk përcaktojnë gjendjen e fakteve që kanë lidhje me marrëdhënien e qirasë së pretenduar në vitet 2006 - 2012, për arsye se nuk përcaktojnë raportin e përdoruesit të ndërtesës me sip. 56 m² dhe pistës me sip. 40 m², në fshatin {***}, Shkodër, me pronarin e sendit në këtë kohë, por flasin për ngjarje të ndodhura pas përfitimit të kësaj shume.

11.4.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për pagimin e tatimit mbi qiranë, *ka qenë qiramarrësi i detyruar, pasi kishte marrë me qira një objekt për biznes, dhe se nuk kishte dijeni për faktin e mosregjistrimit në organet tatimore, ky pretendim nuk është i mbështetur, për arsye se të dhënat për çdo subjekt tregtar janë të hapura për publikun.*

11.4.2.1. Sipas parashikimeve të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9723/2007”), në të cilin parashikohet se “QKR-ja ka këto funksione: [...] d) publikon të dhënat e regjistrimit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to [...]”, dhe të nenit 6 të ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, i shfuqizuar (në vijim “ligji nr. 7667/1993”), që parashikon se: “Regjistri dhe dokumentet e depozituara në aneksin e regjistrimit duhet të paraqiten për t’u konsultuar nga publiku i gjerë gjatë orarit zyrtar në zyrat e gjykatës”, ekziston prezumimi ligjor i pasjes dijeni rreth statusit të personit që ka marrë objektin me qira dhe subjekti nuk mund të shmanget nga përgjegjësia e tij në raport me provueshmërinë e pagimit të tatimit, duke pretenduar mosdijeninë e faktit që z. N. P. nuk ishte i regjistruar si subjekt tregtar në kohën e pretenduar të marrëdhënies së qirasë.

11.4.3. Nga urdhër pagesa, datë 24.10.2016, rezultojnë të dhëna kontradiktore në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket periudhës së qirasë dhe shumës së paguar, përkatësisht: a) subjekti i rivlerësimit pretendon se është paguar qiraja për periudhën 2006 - 2012, por sipas urdhërpagesës së datës 24.10.2016, tatimi në burim është deklaruar për muajin shtator 2016; b) subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga urdhërpagesa e gjeneruar nga sistemi për shumën prej 9.000 lekësh, të kufizuar për muajin shtator 2016, ka paguar pa shkak ligjor, shumën prej 501.000 lekësh.

Pavarësisht përshkrimit të arkëtimit: “{***} Tatim mbi Qira 03/2006 - 31.12.2012” në mandatpagesën e datës 24.10.2016, në {***}, me përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me urdhërues Simon Pashuku, shuma 501.150 lekë dhe periudha mars 2006 - dhjetor 2012 janë të caktuara nga paguesi dhe jo nga organi tatimor.

11.4.4. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pagesa e tatimit mbi qiranë në datën 24.10.2016, në shumën prej 501.000 lekësh, përveç se është kryer pa shkak ligjor, kjo pagesë është kryer tre muaj para dorëzimit të deklaratës *vetting*, vetëm për qëllime të procesit të rivlerësimit⁴⁴ dhe për të justifikuar ligjshmërinë e llogarive bankare prej 20.000 eurosh dhe 11.054 eurosh, si dhe të gjendjes *cash* prej

⁴⁴ *Vendimi nr. 15/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

1.200.000 lekësh, të deklaruara në deklaratën *vetting*. Si pasojë, Kolegji vlerëson se pagesa e tatimit mbi qiranë në datën 24.10.2016, në shumën prej 501.000 lekësh, në kushtet e sipërpërkruara, pra të përgjegjësive ligjore të subjektit për statusin juridik të subjektit tregtar, nuk shëron paligjshmërinë e kësaj të ardhure nga qiraja, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

11.4.5. Në konkluzion të kësaj analize, Kolegji çmon se mbeti në nivel deklarativ provueshmëria e marrëdhënies së qirasë së subjektit me z. N. P. për vitet 2006-2012, qoftë në vetë kohëzgjatjen dhe shtrirjen e saj, ashtu edhe për masën e qirasë së paguar dhe përfitimin real të shumës prej 4.920.000 lekësh sipas deklaratës *vetting*. Po ashtu, kësaj situatë i bashkëlidhet edhe mungesa e pagimit të tatimit mbi të ardhurat e përfituara, element që jo vetëm do të legjitimonte të ardhurën në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, por edhe do të përcillte doza të rëndësishme rreth besueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje në kohën e pretenduar. Pagesa e tatimit me vonesë, në vitin 2016, nga ana e subjektit, jo vetëm që nuk shëron në rastin konkret, mungesën e paligjshmërisë së të ardhurës, por as nuk përfaqëson një vlerë të shtuar drejt provueshmërisë së ekzistencës së vetë marrëdhënies, duke qenë se është kryer në një kohë të vonë.

11.5. Në këto kushte, lidhur me depozitën në shumën prej 20.000 eurosh, në {***}, llogarinë bankare në shumën 11.054 euro në {***} dhe gjendjen *cash* në shumën 1.200.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga qiraja, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie likuiditet, si në drejtim të provueshmërisë së krijimit të tyre, ashtu edhe në drejtim të legjitimitetit të tyre sipas kërkesave të ligjit, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

11.6. Në vlerësimin tërësor të shkeljeve të konstatuara nga kontrolli e vlerësimi i kriterit të pasurisë, e që lidhen me pasurinë apartament, të ndodhur në Shkodër, objektin e ndodhur në fshatin {***} dhe pasuritë likuiditet të ndodhura në sistemin bankar dhe në gjendje *cash*, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm sipas parashkimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se këto pasuri janë krijuar para detyrës së prokurorit dhe nuk duhet të ngarkojnë atë me përgjegjësi për këtë arsye, u gjenden nga Kolegji si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit lidhur me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kolegji vëren se mungesa e burimeve shoqëron jo vetëm pasurinë apartament, në vlerën (-)3.238.692 lekë, për krijimin e së cilës para detyrës nuk rezultojnë dyshime, por ato afektojnë pothuajse krejtësisht pasurinë likuiditet, në vlerën 31.054 euro dhe 1.200.000 lekë, për krijimin e së cilës, para detyrës, niveli i provueshmërisë mbeti krejtësisht në nivel deklarativ.

11.7. Në këto kushte, Kolegji arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit që ka vendosur ndaj tij masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve e zbatim të drejtë të ligjit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 213, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Simon Pashuku.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.04.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi